



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 15.04.2019

**Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.04.2019
shqyrtoi dhe mori vendim për çështjet si më poshtë :**

1. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në Tipin A, B, C dhe D, sipas Vendimit të ERE-S nr. 129, datë 04.06.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.
2. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Furnizuesit.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ndërfushas” me fuqi totale të instaluar 1125 KW..
4. Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit nr. 269, datë 21.12.2018 të Bordit të ERE-s “Mbi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për vitin 2018, i ndryshuar.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**